



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

870/1
Nr. Prot

Shkodër me, 08.01.2026

Lënda: Mbi vendimin Nr.28, datë 23.12.2025 të Këshillit Qarkut Shkodër.

KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 77, gërma ç, neni 78, 83, gërma ç, neni 6/c, dhe 9 i ligjit nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", shqyrtoi vendimin Nr.28, datë 23.12.2025 të Këshillit Qarkut Shkodër "Për miratim niveli të shpërblimit të specialistëve në komisione të KQ". Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



PREFEKTI

Holta DUDA

Prot, 28
dt. 12.01.2026